



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:031094
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05714959

2023:031095

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit A.A. nga Viti me numër personal ..., të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Av. Granit Ramadani, avokat në Viti, ndaj të paditurve N.L., likuidatori i K.e.R., rruga Lagja K.– Blloku ..., nr. ... Prishtinë dhe Kompania e Sigurimeve “K.e.R.”, me seli në Prishtinë, rruga Lagja K.– Blloku ..., nr. ..., me objekt kontesti kompensimin e dëmit jo material dhe material, vlera e kontestit 998,00€, jashtë seancës gjyqësore, me datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore, për shkak të inicimit të procedurës së likuidimit të detyrueshëm ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “K.e.R.”, me seli në Prishtinë.

II. Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të **vazhdohet** kur administratori i falimentimit ta marrë përsipër procedurën apo kur t’i thërrasë gjykata ta bëjë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, av. Granit Ramadani në Viti, me dt. 03.02.2023, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurve N.L., likuidatori i K.e.R., rruga Lagja K.– Blloku ..., nr. ... Prishtinë dhe Kompania e Sigurimeve “K.e.R.”, me seli në Prishtinë, rruga Lagja K.– Blloku B1, nr. 5, me objekt kontesti kompensimin e dëmit jo material dhe material, vlera e kontestit 998,00€.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësit ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi C.nr.2023:031095, të dt. 18.04.2023, i cili së bashku me padinë dhe shkresat e tjera të lëndës i është dërguar të paditurve për të dhënë përgjigje në padi.

I padituri Kompania e Sigurimeve “K.e.R.” me seli në Prishtinë, përmes likuidatorit N.L., më dt. 31.05.2023 ka paraqitur përgjigje në padi-njoftim, ku ka theksuar ndër të tjerash se siguresi K.e.R. me adresë në Lagjën K.Blloku ..., nr. 5 Prishtinë, i revokohet licenca nr. 007, e dt. 25.04.2002 nga Autoriteti Bankar dhe i pagesave të Kosovës, paraardhës ligjor i Bankës Qëndrore të Kosovës, ndaj siguresit “K.e.R.”, hapën procedurat e likuidimit të detyrueshëm sipas Ligjit për Sigurimet me nr. 05/L-045, bazuar në vendimin me nr. .../2021, të dt. 24.09.2021 z. N.L. emërohet likuidator i siguresit “K.e.R.” Sh.A – Kosovë, dëshmia e dëmeve dhe pretenimet kundër siguresit duhet t’i dorëzohen likuidatorit në procedurë të rregullt brenda 90 ditësh pas publikimit të fundit në gazetë, pretendimet e dëmeve të cilat dorëzohen pas afatit ligjor prej 90 ditësh mund të mos shqyrtohen nga ana e likuidatorit, ndërprehet procedura gjyqësore në secilin kontest ku e paditur, debitor është KS “K.e.R.” dhe të njëjtën kërkesë për pretendimet e tij ta dorëzoj në selinë e të paditurës.

Me rastin e vënies në dijeni lidhur me këtë fakt, Gjykata iu referua dispozitës së nenit 277, pika d) të LPK-së, e cila përcakton që: **“Procesi gjyqësor ndërpritet: kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues”**. Bazuar në faktin se në këtë rast është inicuar procedura e likuidimit të detyrueshëm ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “K.e.R.” me seli në Prishtinë, një rrethanë e tillë paraqet pengesë për procedim të mëtutjeshëm në këtë çështje kontestimore, andaj më kuptim të dispozitës së lartëcekur nga neni 277, pika d) të LPK-së, janë plotësuar prezumimet për ndërprerjen e procedurës në këtë çështje. Mbi këtë bazë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 280, par.1 të LPK-së, e cila përcakton që: **“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.”**

Gjykata vë në dukje se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpriten edhe afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale dhe gjatë kësaj kohe gjykata nuk mund të ndërmerrë kurrfarë veprimesh procedurale, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhimit të procedurës.

Mbi bazën e të lartëcekurave, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.2023:031095, datë 21.05.2024

G j y q t a r i,

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.